

VENDIM
Nr.4, datë 6.1.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË
KOMUNËS LUZ I VOGËL TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Luz i Vogël, të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 427 (katërqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna e Luz i Vogël për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Luz i Vogël

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2,3,5,6,8,10,11,12	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
4,7,9,13,402,404,407,409,411,414,417,419	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
21-22	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
24	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
25,65-398	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore	Në pronësi
26-30	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
31-36	Varrezat publike	Në pronësi
37-43	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
44-46	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi